



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTËR I SHTETIT PËR
MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Ditari Mujor

Qershor 2022



RAPORTI DHE KONFERENCA E PARË E ANTIKORRUPSIONIT

U mbajt në Tiranë, më 13 qershor 2022, Konferenca Kombëtare për Antikorrupsionin, ku u paraqit Raporti Kombëtar për vitin 2021, kundër Korrupsionit në Epokën Digjitale. Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, si kontribues kryesor i këtij raporti, vlerësoi nismën e qeverisë shqiptare në orientimin e gjithë sistemit online dhe digjitalizimin si mjet efektiv për të luftuar korrupsionin. Qeveria shqiptare e ka konsideruar digjitalizimin si proces të rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë dhe lehtësimin e qasjes në shërbime për qytetarët dhe bizneset që veprojnë në vend.



AUTOMOTIVE FAIR ALBANIA VJEN NË TIRANË PANAIRI I PARË I AUTOMOTIVIT

Në datat 17, 18 dhe 19 qershor 2022 në ExpoCity - Tirana, u zhvillua panairi i parë i automotivit, një iniciativë e Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR) dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Takimi i shumëpritur për industrinë e dy dhe katër rrotave, një vitrinë rajonale për sipërmarrjet më novatore në trojet shqipfolëse në Automotive Fair Albania. Mundësi unike ndërkombëtarizimi e shkëmbimit të përvojave, shikueshmërisë, rrjetëzimit dhe bashkëpunimeve të reja, e cila që erdhi në momentin e duhur!



MBYLLET THIRRJA E PARË INTERES TEJET I LARTË NGA EKOSISTEMI

Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, pas miratimit të Ligjit 25/2022 dhe të pesë VKM-ve, në mbështetje të ekosistemit të startup-eve, hapi më datë 26 Maj 2022, thirrjen e parë për startup-e dhe lehtësues. Si rezultat i aplikimeve të shumta, por edhe një interesi jashtëzakonisht të madh, thirrja u shty deri më datë 10 qershor 2022, në ndihmë të të gjithë aplikuesve. Së shpejti, Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes do të shpallë fituesit për dy kategoritë, ato startup apo lehtësues.



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTËR I SHTETIT PËR
MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Ditari Mujor Qershor 2022



FORUMET START UP DHE KARRIERA ATY KU TAKOHEN E TASHMJA ME TË ARDHMEN

Pjesë e Automotive Fair Albania ishin dhe Forumet mbi startup-et, inovacionin dhe karrierën. Në Forumin START UP & INOVACIONI, Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes zj. Edona Bilali, në fjalën e saj të hapjes i dha një tjetër qasje orientimit të ekosistemit të startup-eve dhe vetë novacionit. Në përfundim të forumeve, u vlerësuan me certifikata pjesëmarrjeje, nxënësit dhe studentët për punët e tyre novatore, që sjellin në ambientet ku ato studiojnë, por edhe një mundësi e artë për të qenë pjesë e ekosistemit ndërkombëtar.



MINISTERIALI I PLATFORMËS SË BALLKANIT PËRËNDIMOR, NË INTERES TË NOVACIONIT

U mbajt në Tiranë, Ministeriali i rregullt i Platformës së Ballkanit Perëndimor, për Kërkimin dhe Inovacionin. Gjatë fjalës në këtë ministerial, Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes zj. Edona Bilali, solli në vëmendje iniciativën e parë të qeverisë shqiptare për mbështetjen e ekosistemit të startup-eve, për të cilën në katër vitet në vijim ka vënë në dispozicion një fond prej 10 milion Euro. Po ashtu, qeveria ka marrë angazhimin për prezantimin e "Smart Specialization Strategy S3" brenda vitit të ardhshëm. Pjesë e Ministerialit ishte edhe takimi që u zhvillua me përfaqësues të KE-së, të Departamentit të Kërkimit dhe Inovacionit.



DYERT E HAPURA, NJË MUNDËSI E ÇDO NXËNËSI PËR TË QENË PJESË E KABINETIT TË MIHMS

Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, në kuadër të një iniciative "dyert e hapura" të nisura në muajin shtator 2021, ka zhvilluar takime të ndryshme kryesisht me nxënës të shkollave të mesme profesionale ose të përgjithshme, publike dhe private. Gjatë qershorit, në ambientet e kabinetit të Ministrit, zj. Edona Bilali mirëpriti nxënësit e shkollës "Teknike – Ekonomike" Tiranë, ata të Institutit "Harry T. Fultz", si dhe shkollës "Ibrahim Rugova" Kamzë. Nxënësit, por edhe shkollat u ftuan që në thirrjet e ardhshme të jenë pjesë e aplikimeve, qofshin ato startup dhe lehtësues.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTËR I SHTETIT PËR
MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Ditari Mujor

Qershor 2022



AMBASADA E IZRAELIT MBËSHTETET EKOSISTEMIN E STARTUP-EVE

Në një takim që Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes zhvilloi me Ambasadorin e Izraelit në Shqipëri SH.T. Z. Noah Gal Gendler, me praninë edhe të z. Michael Mizrahi, ekspert i ekosistemit të Startup-eve në Izrael. Për shkak të vlerësimit reciprok dhe marrëdhënieve të shkëlqyera, ambasadori nxiti z. Mizrahi, që në vizitën e ardhshme të zhvillojmë një takim me përshpejtuesit e ekosistemit tonë të startup-eve për të marrë përvojën e Izraelit, që e ka transformuar atë në një qendër botërore të inovacionit dhe teknologjisë. Ky takim vjen si rezultat i thirrjes së MSHMS për startup-et dhe lehtësuesit, si dhe interesit të shtuar të rinisë dhe jo vetëm.



RINIA SHQIPTARE NË BOTË NJË ARSYE PËR TË QENË KRENAR QË TË GJITHË

Në një takim që Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes zj. Edona Bilali, zhvilloi me Eglentin dhe dy shqiptarë që prej 16 vitesh jetojnë e punojnë në Gjermani: Loina Prifti pranë kompanisë BMW dhe Stiv Sterjo pranë kompanisë Google, vlerësoi arritjen e tyre të deritanishme. Në vijim të takimit, u diskutua mbi një projekt tejet ambicioz dhe me impakt nga Google, si një nismë që do të jetë për herë të parë në Shqipëri. Prej vitesh të mirëpozicionuar në tregun evropian, Loina dhe Stiv po shikojnë si mund të japin mbrapsht për vendin e tyre pjesë të njohurive dhe rrjetit të tyre në shërbim të të rinjve drejt botës të digjitalizimit.



SHQIPËRIA NË TË NJËJTAT HAPA ME PERËNDIMIN INVESTIME DHE TURIZËM I SË ARDHMES

Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, zj. Edona Bilali mori pjesë në ceremoninë e nënshkrimit të Marrëveshjes së Hotel Tirana me Intercontinental Hotel & Resorts, një nga markat globale “5 Star Luxury”. Intercontinental Hotel & Resorts vjen me një investim brand dhe me standardet ndërkombëtare, që i shtohet turizmit, por edhe shërbimeve në vend. Shqipëria, si një vend në zhvillim po ecën me hapa të sigurtë në investime madhore duke i dhënë jo vetëm kryeqytetit një imazh të metropoleve perëndimore, por në të njëjtën kohë duke sjell të ardhura dhe vende pune sidomos për të rinjtë, që janë pjesë e tregut me një formim profesional bashkëkohorë.